

KONTRATE SHITBLERJE (KUOTASH)
“ORIGO HYDROPOWER” SHPK L76401206P

Ne Vlore, sot me date 31.05.2021 (dymije e njezet e nje), ne seline e Shoqerise “ORIGO HYDROPOWER” SHPK ne Vlore, Rruga Gjergj Kastrioti, Godina Nr.1, u paraqiten palet e meposhtme ku kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash si me poshte:

SHITESI:

Fation Veizaj, i dtl. 18.09.1966, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. Personal G60918033N, i cili perfaqeson 100 % te kuotave te shoqerise (me poshte i quajtur “Shitesi”)

BLERESI:

Z. Kujtim KALE, atësia: Kujtim, i datëlindjes 08.10.1979, lindur në Tiranë, e banuese në Tiranë, Rruga e Duresit ”, Pall 81 shk 4 Ap 28, identifikuar me ID me nr. personal H91008132K (me poshte i quajtur “Bleresi”);

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t’i referohemi si “Pale”, dhe bashkerisht do t’u referohemi si “Palet”. Te dyja palet duan te lidhin kete marreveshje per Shit-Blerjen e 100 % te Kuotave te Shoqerise “ORIGO HYDROPOWER” SHPK si me poshte vijon:

Te pergjithshme

A. Shitesi eshte zoterues i 100% te kuotave ne Shoqerine “ORIGO HYDROPOWER” SHPK. Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me numer NUIS **L76401206P**.

B. Shitesi deshiron t’i shese Bleresit 100 % te kuotave qe zoteron ne kete shoqeri dhe Bleresi deshiron te bleje sipas kushteve te kesaj kontrate dhe pas kalimit te kuotave behet pronar ne masen 100% te shoqerise “ORIGO HYDROPOWER” SHPK.

C. Ortaku me ane te vendimit te asamblese date 31.05.2021 ka miratuar shitjen e kuotave, emeruar administratorin e ri te shoqerise dhe autorizuar administratorin e ri te Shoqerise per regjistrimin e kontrates dhe ndryshimin e administratorit ne QKB.

E. Ne perputhje me nenin 117 pika b “Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave”, te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise “Dispozitat e Pergjithshme per kontraten e shitjes”, dhe ne pergjithesi te legjislacionit shqiptar ne fuqi, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon nepermjet shitblerjes se 100 % te kapitalit te zoteruar ne shoqeri si dhe te drejten e pronesise mbi 100 % te kuotave dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje Bleresit, duke e garantuar plotesisht titullin e pronesise te pa renduar me barre dhe Bleresi nga ana tjeter blen nga Shitesi kuotat kundrejt nje çmimi te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1 Çmimi i plote i shitjes se kuotave eshte 100 000 leke.

Neni 3

Pagesa

3.1. Çmimi eshte paguar nga bleresi te shitesi para nenshkrimit te kontrates.

Neni 4

Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat

4.1 Me nenshkrimin e kontrates ortaku i Shoqerise "ORIGO HYDROPOWER" SHPK me 100 % te kuotave eshte Z. Kujtim KALE.

4.2 Kalimi i pronesise se ligjshme mbi kuotat nga Shitesi te Bleresi do te kryhet menjehere me nenshkrimin e kontrates.

Neni 5

Garancite

Shitesi ne lidhje me kuotat qe zoteron, garanton Bleresin:

5.1. Se kuotat jane te lira dhe ka zbatuar parashikimet e statutit ne lidhje me te drejtat e parablerjes.

Neni 6

Regjistrimi

6.1. Regjistrimi i kalimit te kuotave nga Shitesi te Bleresi ne Qendren Kombetare te Biznesit do te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kontrates.

6.2 Me nenshkrimin e Kontrates se Shitjes pala shitese Z. Fation Veizaj nuk ka asnje te drejte apo detyrim ndaj Shoqerise "ORIGO HYDROPOWER" me NUIS L76401206P.

Neni 8

Ligji i zbatueshem

8.1. Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji "Per Qendren Kombetare te Biznesit" si dhe perkatesisht dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarreshjeve

9.1. Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tirane.

Neni 10

Te ndryshme


10.1 Nenet e pergjithshme jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

10.2 Kjo kontrate mund te ndryshoje vetem me pelqimin e te dyja paleve duke respektuar formen shkresore te noterizuar.

10.3 Kjo kontrate u perpilua ne 2 (kopje) kopje me vlere te barabarte ligjore.

Shitesi

Z. Fation Veizaj



Bleresi

Z. Kujtim Kale

